

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E  
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL AGJENCIA  
PËR ZHVILLIM BUIQËSOR DHE RURAL

Tiranë, datë 14.10.2019

**NJOFTIM PËR SHTYP**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bën më dije opinionin publik në lidhje me aplikantët përfitues nga “Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019”, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 3/1, datë 15.04.2019, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”.

AZHBR, në rolin e saj si agjenci zbatuese, ka ndjekur me përpikmëri procedurat bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.128, Datë 13.03.2019, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019", dhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nga ministritë e linjës, duke bërë publike “Listat e Aplikimeve të Kualifikuara”, në faqen zyrtare: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), për secilën masë mbështetëse të financuar nga programi kombëtar, viti 2019.

Më tej, Agjencia e Pagesave ka shpallur “Listën e përfituesve sipas qarqeve”, dhe bën më dije se kanë përfituar subvencione mbështetëse nga programi kombëtar për mbështetje në bujqësi 2,896 fermerë, me vlerë financimi 482,023,550 Lekë, disbursuar deri më datë 14.10.2019, për 12 qarqet e vendit.

Në lidhje me Masën 2: “Dorëzim qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 Lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat që mbarështojnë lopë dhe/ose të imëta” disbursuar deri më datë 14.10.2019, kanë përfituar 1,425 fermerë me vlerë financimi 139,702,730 Lekë. AZHBR do të njoftojë në faqen zyrtare [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), dhe përmes Agropikave, nëse do të alokohen fonde shtesë pas miratimit të aktit normativ për shtesën e buxhetit.

Në total aplikantët përfituesë për çdo masë mbështetëse nga Programi për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2019 janë:

- **Masa 1:** “Për tufën bazë të matrikulluar me dele/dhi” – 547 aplikantë përfitues me vlerë financimi: 124,757,000 Lekë,
- **Masa 2:** “Mbështetje për dorëzimin e qumështit lëndë e parë në pikat e grumbullimit për fermat me lopë/të imta” – janë 1,865 pagesa të kryera për 1,425 aplikantë përfitues me vlerë financimi: 139,702,730 Lekë,
- **Masa 3:** “Mbështetje për mbarështim në bletari” – 564 aplikantë përfitues me vlerë financimi: 69,674,000 Lekë,
- **Masa 4:** “Dorëzim prodhimi për anije peshkimi” – 1 aplikant përfitues me vlerë financimi: 3,279,300 Lekë,
- **Masa 5:** “Mbjellje ullishte të reja” - 238 aplikantë përfitues me vlerë financimi: 58,000,959 Lekë,
- **Masa 5.1:** “Përmirësimi ullishtesh të degraduara” - 5 aplikantë përfitues me vlerë financimi: 311,150 Lekë,
- **Masa 6:** “Përmirësimi i teknikave të ujitjes në ullishte” - 62 aplikantë përfitues me vlerë financimi: 11,001,828 Lekë.

AZHBR është e angazhuar maksimalisht në procese transparente, ndaj ka marrë masa transformuese në administrimin sa më eficient të aplikimeve të fermerëve, duke zbatuar aplikime online me "0 Dokumenta". Në zbatim të misionit të saj ka çelur 20 Agropika në qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Librazhd, Pogradec, Korçë, Përmet, Gjirokastrë, Sarandë, Lezhë, Shkodër, Pukë, Kukës, Dibër, Mat, për të qenë pranë fermerëve, dhënë informacionin e duhur, shërbim të dedikuar me në qendër fermerin për programet mbështetëse nga Skema Kombëtare dhe Programi IPARD II, bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Shqiptare, në rritje të kapaciteteve prodhuese dhe ekonomisë familjare.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUIQËSOR DHE RURAL